



MARRËVESHJE E BASHKËPUNIT

I. Palët nënshkruese:

UNIVERSITETI I PEJËS "HAXHI ZEKA"
30000 Pejë, Republika e Kosovës
Rr. "UÇK-së"

ALEANCA KOSOVARE E BIZNESEVE
50000 Gjakovë, Republika e
Kosovës, Rr. "UÇK-së"

Preambula:

Universiteti "Haxhi Zeka" i Pejës dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve (në vijim të referuara si "Palët"), me qëllimin e bashkëpunimit për promovimin e lidhjeve kërkimore-shkencore, arsimore dhe kulturore mes dy institucioneve, kanë arritur marrëveshjen e bashkëpunimit sipas kushteve të përcaktuara në vijim.

Kjo marrëveshje do të realizohet në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe do të mundësojë zhvillimin e mëtejshëm dhe shqyrtimin e programeve të veçanta të bashkëpunimit, me interes të përbashkët për të dy palët.

II. Objekti i Marrëveshjes:

Bashkëpunimi do të zbatohet nëpërmjet, por nuk mund të jetë i kufizuar në, veprimtaritë e mëposhtme:

1. Rjetëzim dhe shkëmbim i informacionit;
2. Pjesëmarrje dhe aplikim për fonde të përbashkëta;
3. Aktivitete të përbashkëta;
4. Organizimi i ngjarjeve shkencore;
5. Shkëmbimi i informacionit në fusha të ndryshme;
6. Bashkëpunim në projekte ndërkombëtare dhe kombëtare;
7. Aktivitetet e përbashkëta në fushën e kërkimeve shkencore dhe të tregut;
8. Qasja në bazën e të dhënave;
9. Aktivitete të tjera me interes të përbashkët;

Për zbatimin e programeve të veçanta të bashkëpunimit, do të negociohet dhe rënë dakord për një marrëveshje të shkruar që do të mbulojë të gjitha aspektet relevante, përfshirë financimin dhe detyrimet e tjera që secila palë do të marrë përsipër. Kjo marrëveshje do të formalizohet me shkrim para fillimit të programit.

III. Zbatimi i Marrëveshjes:

Çdo institucion do të caktojë një person kontaktues për të koordinuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Palët janë angazhuar të mos realizojnë veprimtaritë e lidhura me këtë marrëveshje pa u konsultuar paraprakisht me njëra-tjetrën.

Palët bien dakord që të gjitha marrëveshjet financiare të nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të negociohen dhe do të varen nga disponueshmëria e fondeve. Asnjëra palë nuk do të ketë asnjë detyrim financiar ndaj palës tjetër në kuadër të kësaj marrëveshjeje.

Palët së bashku do të caktojnë një plan vjetor për aktivitete të përbashkëta.

IV. Kohëzgjatja e marrëveshjes:

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e institucioneve dhe do të mbetet në fuqi për pesë (5) vjet, me mundësi zgjatjeje nga palët për një periudhë të mëtejshme. Amandamentimet dhe ndryshimet mund të bëhen vetëm nëse miratohen me shkrim nga rektorët e të dy palëve dhe do t'i shtohet kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje mund të ndërpritet para përfundimit të periudhës pesë (5) vjeçare vetëm me pëlqimin e të dy palëve, në formë të shkruar.

Çdo palë që dëshiron të bëjë ndryshime ose të ndërpresë marrëveshjen, duhet ta njoftojë institucionin tjetër me shkrim për këtë qëllim, jo më vonë se gjashtë (6) muaj para datës kur ndryshimet e sugjeruara ose ndërprerja duhet të hyjnë në fuqi.

Marrëveshja nuk mund të ndërpritet nëse ky veprim rrezikon zbatimin e ndonjë prej aktiviteteve të dakorduara, ose para se të përfundojnë aktivitetet e filla brenda afatit të përcaktuar.

V. Numri i Kopjeve të Marrëveshjes:

Marrëveshja do të jetë e shkruar dhe do të nënshkruhet në dy (2) kopje, në gjuhën shqipe. Secila palë do të marrë një kopje.

Në dëshmi të kësaj, palët e mësipërme do të vendosin nënshkrimet e tyre poshtë këtij dokumenti:

Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë
Prof. dr. Armand Krasniqi rektor

Aleanca Kosovare e Bizneseve
Mr.sc. Argjend Fetahu

Nënshkrimi dhe vula

REKTORATI

Nr. / Br. / Str. 085 Nr. i faq / Br. str / No. pg 2

Data / Datum / Dato: 27.01.2025. Pejë / Poë

Nënshkrimi dhe vula

